

Fillimi > -Kronikë

VIDEO/ Kishin planifikuar të kryenin një vrasje kundrejt pagesës, arrestohen 3 persona në Durrës (EMRAT)

30 Gusht, 2021 09:40



Durrës - Finalizohet operacioni policor i koduar "Misioni". Sekuestrohet arsenal armësh, në pranga 3 shtetas

Madhësia e tekstit: - +

 Parandalohet një ngjarje e rëndë kriminale në Durrës. 3 persona, dy prej të cilëve me precedentë penale, kanë rënë në prangat e policisë, pasi po planifikonin të kryenin një vrasje me pagesë.

 Në kuadër të operacionit të koduar "Misioni" u arrestuan; Aldi Mustafa, 35 vjeç, banues në Durrës, i dënua më parë për veprat penale "Kanosja" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", i dënua më parë me 10 vite burg, në Gjermani;

 Uran Zyka, 40 vjeç, banues në Durrës, i dënua më parë për veprën penale "Kanosja". Të dy këta shtetas janë me precedent të theksuar kriminal në fushën e krimeve ndaj personit si dhe Tahir Gjini, 33 vjeç, banues në Durrës.

NJOFTIMI I POLICISE

Finalizohet nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Durrës, në bashkëpunim me strukturat hetimore të DVP Durrës, operacioni policor i koduar "Misioni". Arrestohen në flagrancë 3 shtetas, 2 prej tyre me precedent të theksuar kriminal në fushën e krimeve ndaj personit dhe pronës, shpërndarjes së lëndëve narkotike dhe armëmbajtjes pa leje.

Tre të ndaluarit dyshohet se do kryenin një vrasje, kundrejt pagesës. Sekuestrohen 3 pistoleta me fishekë në fole dhe 1 mitraloz me fishekë në fole, gati për qitje, municion luftarak, vlera monetare dhe sende të tjera.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Durrës, në bashkëpunim me strukturat hetimore të DVP Durrës, në vijim të punës për rritjen e parametrave të sigurisë në qytet, kapjen e personave në kërkim ose atyre që disponojnë armë zjarri me vete, në bazë të informacioneve të siguruar nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Durrës, organizuan punën dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar "Misioni", në kuadër të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

Aldi Mustafa, 35 vjeç, banues në Durrës, i dënua më parë për veprat penale "Kanosja" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", i dënua më parë me 10 vite burg, në Gjermani;

Uran Zyka, 40 vjeç, banues në Durrës, i dënua më parë për veprën penale "Kanosja". Të dy këta shtetas janë me precedent të theksuar kriminal në fushën e krimeve ndaj personit.

Tahir Gjini, 33 vjeç, banues në Durrës.

Këta shtetas qarkullonin në lagjen nr.15, Durrës, me mjetin tip "BMW", me drejtues shtetasin Aldi Mustafa. Në momentin e ndërhyrjes nga shërbimet e Policisë, të tre shtetasit kanë tentuar të largohen duke goditur mjetin e shërbimit të Policisë dhe duke rrezikuar jetën e punonjësve të Policisë që ishin në operacion, por nuk kanë mundur dot pasi janë bllokuar nga mjete dhe shërbime të tjera të Policisë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në mjet u gjetën: 3 armë zjarri pistoletë me fishekë në fole, 1 armë zjarri mitraloz me fishekë në fole gati për qitje, municion luftarak, 2 laptopë, 9 telefona celularë dhe 1600 euro, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale së bashku me automjetin.

Strukturat hetimore të Policisë, nën drejtimin e Prokurorisë, po vijojnë intensivisht punën hetimore për zbardhjen e plotë të këtij rasti.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprat penale "Armëmbajtje pa leje".


Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

TË NGJASHME



01 Shtator, 2021

Vaksinimi në botë/ Kryesojnë Malta, Singapori dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, Shqipëria ka 22% të popullsisë të vaksinuar plotësisht



01 Shtator, 2021

Shtëpia e Bardhë dënon ndalimin e abortit në Teksas: Është një kërcënim ekstrem, hera e parë që një grua nuk ka të drejtë të zgjedhë

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Largohen nga Qytet Studenti afganët e strehuar aty, ja në cilin qytet janë zhvendosur

01 Shtator, 2021

01 Shtator, 2021

Raporti alarmant i OKB për klimën, ambasada e SHBA: Duhet zvogëluar sa më parë emetimi global i dioksidit të karbonit, ndryshe...

01 Shtator, 2021

Goditet banda e trafikut ndërkombëtar të drogës në Greqi, në pranga 4 shqiptarë, sekuestronet lëndë narkotike, mijëra euro dhe makina

01 Shtator, 2021

Nga Kabuli në Tiranë/ Historia e atletes që u arratis nga Afganistani, tregon dhunën e talebanëve ndaj nënës dhe motrës së saj: Groposëm gjithëcka!

Video/ Policia 'kap mat' dhe ndëshkon qindra shoferë autobusësh brenda dhe jashtë Tiranës

01 Shtator, 2021

Mega-operacioni në Spanjë, reagon ministri Çuqi: Do vijojë hetimi për burimet e pasurive në Shqipëri për të implikuarit

01 Shtator, 2021

KATEGORIA VIDEO

Reja nuk e ka frikë Poloninë: Respekt për të gjithë, nuk trembemi nga asnjë kundërshtar

01 Shtator, 2021

Kërkesa e Ramës, Presidenti i Bullgarisë i përgjigjet në sy: Dera është e hapur për negociatat, Ju ftoj në dialog

01 Shtator, 2021

"Ju lutem", Rama kërkesë Presidentit të Bullgarisë: Bëhuni ballkanas, hapni rrugën, na lini të flasim me BE

01 Shtator, 2021

01 Shtator, 2021

"Nuk është e lehtë të presësh 16.5 vite"! Zaev mesazh të qartë BE-së: Duhet të hidhni hapin tjetër, të dimë që një ditë do integrohemi!

01 Shtator, 2021

01 Shtator, 2021

Kurti: BE duhet mbrojtur e përkrahur, me anëtarësimin e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor kufiri i jashtëm do të jetë më i sigurt